

VENDIM
Nr. 90, datë 16.7.2019

**NDIHMJA SHTETËROR “FONDI GRANT ‘PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE
NË KONVIKTET E STUDENTEVE’ TË BASHKISË TIRANË”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

Znj. Anila Denaj	kryetare;
Znj. Mimoza Dhëmbi	anëtare;
Znj. Etleva Haka	anëtare;
Znj. Mirjana Zisi	anëtare;
Z. Ahmet Mançellari	anëtar.

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 16.7.2019, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’”, mori në shqyrtim njoftimin e ndihmës së kryer nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë lidhur me fondin grant “Për përmirësimin e kushteve në konvikte të studenteve” të Bashkisë Tiranë.

I. Procedura

1. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) me shkresën nr. 5331, datë 17.5.2019 “Kërkesë për miratimin e ndihmës shtetërore për fondet ‘Grand’ për përmirësimin e kushteve në konvikte të studentëve të Bashkisë Tiranë”, kërkon miratimin e grantit pranë Komisionit të Ndihmës Shtetërore. MFE-ja, me shkresën nr. 9407/1, datë 30.5.2019, i kërkoj MASR-së njoftimin e planit në përputhje me nenin 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, të shoqëruar me Formularin Bazë për njoftimin e ndihmave shtetërore të përcaktuar në aneksin 1 të VKM-së nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’”. MASR-ja me shkresën nr. 5331/1, datë 21.6.2019, dërgoi në MFE njoftimin e skemës së ndihmës shtetërore.

II. Përshkrimi i masës

2. Objektivi: Plani i njoftuar synon përmirësimin e kushteve në konvikte të studentëve të Bashkisë Tiranë, në vlerën 300 000 000 (treqind milionë) lekë për vitin 2019, duke transferuar fondet nëpërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

3. Baza ligjore: vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 13.3.2019 “Për procedurat e transferimit të fondit grant ‘Për përmirësimin e kushteve në konvikte të studentëve’”, të Bashkisë Tiranë, pika 2, parashikon që:

“Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, pas miratimit nga Komiteti i Ndihmës Shtetërore, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të transferohet nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë te përfituesi, ndërmarrja/et e trajtimit të studentëve, me pronar Bashkinë Tiranë, si transfertë në llogarinë e përfituesit në bankën e nivelit të dytë”.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

4. Neni 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, përcakton se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembëroje konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

5. Ligji i ndihmës shtetërore nr. 9374/2005, zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1: a) burime shtetërore, b) avantazhi ekonomik dhe selektiviteti dhe c) efekti në konkurrencë / tregti.

Skema e njoftuar aktivizon burime shtetërore nga buxheti i shtetit (Programi buxhetor “Arsimi i Lartë”). Përfitues i fondeve të MASR-së është Bashkia e Tiranës, që në kuptim të ligjit nr. 9374,

datë 21.4.2015 “Për ndihmën shtetërore”, nuk konsiderohet një “ndërmarrje” me veprimtari ekonomike¹.

Mbështetur në vlerësimet e mësipërme, në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson se masa e njoftuar nuk përbën ndihmë shtetërore.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 17, 22 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Fondi Grant “Për përmirësimin e kushteve në konviktet e studenteve” të Bashkisë Tiranë, në vlerën 300 000 000 (treqind milionë) lekë, për vitin 2019, nuk përbën ndihmë shtetërore.
2. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Anila Denaj

¹ Neni 3, pika 2, e ligjit nr. 9374/2005: “Ndërmarrje” është çdo person fizik ose juridik, privat ose publik, që kryen veprimtari ekonomike.